

LIGJ
Nr. 17/2020

PËR PRODUKTET PLEHËRUESE
(Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- garantimin e shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i produkteve plehëruese;
- rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elemente ushqyese;
- përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe të pjellorisë së tokës.

Neni 2

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin e funksionimit të strukturave përkatëse.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- produktet plehëruese që regjistrohen, prodhohen, eksportohen, tregtohen, importohen dhe përdoren në Republikën e Shqipërisë;
- personat fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, si dhe të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, vlerësimin e ndikimit në mjedis, lejet e mjedisit e kimikatet.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ambalazhim” është një ambalazh i mbyllur që përdoret për të mbajtur, mbrojtur e për të lehtësuar shpërndarjen e produkteve plehëruese.
2. “Aplikant” është personi apo subjekti që prodhon një produkt plehërues, që ia beson prodhimin e tij një të treti ose një personi të emëruar nga prodhuesi, si përfaqësues i autorizuar i tij, i cili paraqet kërkesë për regjistrimin e produktit plehërues.
3. “Deklarim për produktet plehëruese” është specifikimi i përqendrimit të lëndëve ushqyese, duke përfshirë formën dhe tretshmërinë, të garantuara brenda tolerancave të përcaktuara.
4. “Dokumentacion shoqërues” është dokumentacioni që shoqëron produktin plehërues.
5. “Elemente ushqyese” janë elementet kimike të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e bimëve, përveç karbonit (C), oksigjenit (O) dhe hidrogjenit (H), të cilët furnizohen/disponohen kryesisht nga ajri dhe uji. Elementet kimike ushqyese klasifikohen si:
 - a) “elemente ushqyese kryesore”, vetëm elementet azot, fosfor dhe kalium;
 - b) “elemente ushqyese dytësore”, elementet kalcium, magnez, natrium dhe squfur.
6. “Etiketë” është format i shkruar në letër, plastikë apo material tjetër i ngjashëm me to që i bashkëngjitet një produkti dhe jep informacion për të.
7. “Etiketimi” është vendosja e etiketës në paketimin parësor ose të jashtëm.
8. “Grupet e produkteve plehëruese” janë produktet plehëruese që kanë të njëjtin emër tipologjik, si dhe tipare e cilësi të përbashkëta mes tyre.
9. “Gjurmueshmëri” është ndjekja e një produkti plehërues në të gjitha fazat, nga prodhimi deri te përdoruesi i fundit.
10. “Hedhje në treg” është bërja e disponueshme e produktit plehërues në treg për shpërndarje, konsum ose përdorim të tij gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.
11. “Heqje nga tregu” është çdo masë që synon parandalimin e të bërit të një produkti plehërues në zinxhirin e furnizimit të disponueshëm në treg.
12. “Import” është hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e produkteve plehëruese. Importi është pjesë e veprimtarisë së tregtimit me shumicë.
13. “Importues” është çdo person fizik ose juridik i regjistruar në Shqipëri, i cili vendos në tregun shqiptar një produkt plehërues nga një vend tjetër.
14. “Institucioni përgjegjës” është institucioni/institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij ligji, sipas përcaktimeve të nenit 22 të tij.
15. “KRPP” është komisioni i regjistrimit të produkteve plehëruese.
16. “Korrektues” janë materialet që duhet të shtohen në tokë, kryesisht për të modifikuar e përmirësuar vetitë kimike anormale të saj, të shkaktuara nga reaksioni, kripshmëria, përmbajtja e natriumit.
17. “Laborator i akredituar” është laborator i cili ka kaluar një procedurë akreditimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e akreditimit.
18. “Laborator reference” është laborator i akredituar që vlerëson cilësinë e besueshmërinë e analizave të kryera nga laboratorët e miratuar dhe jep vlerësimin përfundimtar të analizave të kryera nga këta laboratorë.
19. “Laborator i miratuar” është laborator publik ose privat, i miratuar nga ministri, për kryerjen e analizave të produkteve plehëruese.
20. “Llojet e produkteve plehëruese” janë produktet plehëruese që përfshihen brenda një grupi.
21. “Magazinë” është objekt i veçantë që shërben për ruajtjen dhe shpërndarjen me shumicë të produkteve plehëruese të njësitë të tregtimit me pakicë.
22. “Magazinin” është koha e qëndrimit të produkteve plehëruese në magazinë.
23. “Material organik” është produkti organik me origjinë natyrore, i cili mund të identifikohet si lëndë për prodhimin e produkteve plehëruese organo-minerare.
24. “Mikroelemente” janë elementet bor (B), kobalt (Co), bakër (Cu), hekur (Fe), mangan (Mn), molibden (Mo) dhe zink (Zn). Këto elemente janë thelbësore për rritjen dhe zhvillimin e bimëve, edhe pse në sasi të vogla, nëse krahasohen me elementet ushqyese kryesore dhe dytësore.
25. “Ministër” është ministri përgjegjës për bujqësinë.

26. “Ministri” është ministria përgjegjëse për bujqësinë.
27. “Njësi e tregimit me shumicë” është njësi që shërben për tregtimin e produkteve plehëruese të njësitë të tregimit me pakicë.
28. “Njësi e tregimit me pakicë” është njësi që shërben për tregtimin e produkteve plehëruese të përdoruesi i fundit.
29. “Përfaqësues i autorizuar” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili ka një akt përfaqësimi nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, për detyrimet e prodhuesit që parashikohen në këtë ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij.
30. “Përmbajtje e deklaruar për produktet plehëruese” është përmbajtja e një elementi ose e formave të tij, e cila tregohet në etiketën ose dokumentin që shoqëron një produkt plehërues.
31. “Përmbajtje e padeklaruar për produktet plehëruese” është përmbajtja e një elementi ose e formave të tij, e cila nuk tregohet në etiketën ose dokumentin që shoqëron një produkt plehërues.
32. “Përmirësues të tokës” janë materialet që duhet të shtohen në tokë, kryesisht për të ruajtur ose përmirësuar karakteristikat fizike ose kimike, ose aktivitetin biologjik të saj, veçmas ose së bashku me njëri-tjetrin.
33. “Plehërues” është produkti, funksioni kryesor i të cilit është të sigurojë elemente ushqyese për bimët.
34. “Produkt plehërues - PP” është lënda, përzierja, mikroorganizmi ose çdo material tjetër që përdoret të bimët ose rizosfera e tyre, vetëm ose i përzier me material tjetër, me qëllim furnizimin me elemente ushqyese ose përmirësimin e efikasitetit në të ushqyerit të bimëve.
35. “Produkt plehërues inorganik” është produkti plehërues, në të cilin elementet ushqyese të deklaruara janë të pranishme në formën e përbërjeve minerale të përfutuara nga nxjerrja ose proceset fizike e kimike industriale ose proceset industriale fizike ose kimike. Kalcium cianamidi, ureja dhe produktet e saj të kondensimit e të lidhjes, si dhe produktet plehëruese që përmbajnë mikroelemente të kuluara ose komplekse mund të klasifikohen si produkte plehëruese inorganike.
36. “Produkt plehërues organik” është produkti plehërues që rrjedh nga materialet organike me origjinë shtazore ose bimë, të përbërë nga përbërësit organikë, në të cilët elementet kryesore të fertilitetit janë të lidhura kimikisht në formë organike ose, në çdo rast, formojnë një pjesë integrale të materialit.
37. “Produkt plehërues organo-mineral” është produkti plehërues, i përfutur nga reaksioni ose përzierja e një ose më shumë produkteve plehëruese organike, ose të një apo më shumë materialeve organike, ose të dyja, me një ose më shumë produkte plehëruese inorganike.
38. “Produkte plehëruese me veprim specifik” janë produkte plehëruese që kontribuojnë në mënyrë specifike në tokë, bimë ose te produktet plehëruese, të cilat nxisin ose rregullojnë përvetësimin e elementeve ushqyese ose korrigjojnë anomalitë e caktuara fiziologjike.
39. “Produkte plehëruese të veçanta” janë produkte plehëruese që veprojnë si substanca për të nxitur efikasitetin e për të rregulluar përthithjen e elementeve ushqyese.
40. “Produkt plehërues i thjeshtë” është produkti plehërues azotik, fosfatik ose potasik, për të cilin mund të deklarohet vetëm një nga përbërësit kryesorë të elementeve ushqyese.
41. “Produkt plehërues i përbërë” është produkti plehërues që ka një përmbajtje të deklaruar të të paktën dy prej elementeve ushqyese kryesore dhe të siguruara në rrugë kimike ose nga përzierja apo një kombinim i të dyjave.
42. “Produkt plehërues i përzier” është produkti plehërues që sigurohet nga përzierja e thatë e produkteve plehëruese të ndryshme, pa shkaktuar reaksione kimike.
43. “Produkt plehërues kompleks” është produkti plehërues i përbërë, i përfutur nga reaksioni kimik, si solucion apo në gjendje të ngurtë nga granulimi, që ka një përmbajtje të deklaruar të të paktën dy prej elementeve ushqyese kryesore. Në gjendje të ngurtë çdo grimcë përmban të gjitha elementet ushqyese përbërëse të tyre, të deklaruara.
44. “Produkte plehëruese për bujqësinë organike” janë produktet plehëruese, për të cilat lejohet përdorimi sipas metodës së prodhimit organik, sipas legjislacionit të bujqësisë organike.
45. “Produkt plehërues i hapur” është produkti plehërues jo i paketuar (rifuxho).

46. “Produkt plehërues i tjetërsuar” është çdo ndryshim i treguesve të produktit plehërues nga ato të deklaruara në etiketë ose në certifikatën shoqëruese të analizës.

47. “Produkt plehërues i rrjedhur” është produkti plehërues i lëngshëm, i cili ka rrjedhur gjatë ruajtjes ose transportit.

48. “Produkt plehërues me rrezikshmëri” është produkti plehërues i thjeshtë me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti.

49. “Prodhim” është procesi i nxjerrjes së gatshme për përdorim të produkteve plehëruese, duke përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin e tyre.

50. “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një produkt plehërues ose ka një produkt të disenuar dhe e tregon këtë produkt nën emrin dhe/ose markën e tij tregtare.

51. “Regjistër i prodhuesve të produkteve plehëruese” është tërësia e të dhënave zyrtare, ku regjistrohen prodhuesit e produkteve plehëruese në territorin e Republikës së Shqipërisë.

52. “Reklamim për produktin plehërues” është çdo formë informimi, veprimtarie mbështetëse ose nxitëse e destinuar për të rritur informimin për përdorimin e produktit plehërues.

53. “Seri” është një sasi e caktuar e lëndës së parë e materialit ambalazhues ose e produktit përfundimtar, prodhuar gjatë një procesi të vetëm ose e disa proceseve të njëpasnjëshme, e cila siguron homogenitetin e gjithë sasisë.

54. “SPPP” është struktura përgjegjëse për produktet plehëruese në ministri.

55. “Substrate kultivimi” janë materialet, përveç tokës, ku rriten bimët.

56. “Tolerancë” është shmangia e lejuar e vlerave të matura të përmbajtjes së elementeve ushqyese nga vlera e deklaruar e tyre.

57. “Tregtim i produkteve plehëruese” është veprimtaria e tregtimit me shumicë dhe me pakicë, e cila lidhet me blerjen, magazinimin, shpërndarjen, prezantimin për shitje ose shitjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të produkteve plehëruese.

58. “Vendosje në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e produktit plehërues në treg.

Neni 5

Klasifikimi produkteve plehëruese

1. Produktet plehëruese klasifikohen në grupe si më poshtë:

a) produktet plehëruese inorganike;

b) produktet plehëruese organike;

c) produktet plehëruese organo-minerare;

ç) produktet plehëruese bazuar në elemente ushqyese dytësore;

d) produktet plehëruese bazuar në mikroelemente;

dh) produktet plehëruese me veprim specifik (frenuesit, biostimulantët e bimëve);

e) produktet plehëruese të veçanta;

ë) korrektuesit;

f) substratet e kultivimit (rritjes);

g) përmirësuesit e tokës;

gj) materialet organike të destinuar për prodhimin e produkteve plehëruese organo-minerare.

2. Klasifikimi i hollësishëm i produkteve plehëruese të lejuara për regjistrim miratohet me urdhër të ministrit.

KREU II

PRODIMI DHE REGJISTRIMI I PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Neni 6

Prodimi i produkteve plehëruese

1. Prodimi i produkteve plehëruese në Republikën e Shqipërisë kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet e lejet, si dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

2. Prodimi i produkteve plehëruese në vend kryhet nga persona juridikë ose fizikë, pas certifikimit nga një trupë certifikuese, e akredituar në përputhje me standardin SSH ISO/IEC 17065.

3. Prodimi i produkteve plehëruese me rrezikshmëri përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Prodimi i produkteve plehëruese me rrezikshmëri kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar e të pajisur me lejen përkatëse të mjedisit për këtë veprimtari, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi, si dhe pas certifikimit nga një trupë certifikuese, e akredituar në përputhje me standardin SSH ISO/IEC 17065.

Neni 7

Kërkesat që duhet të plotësohen për regjistrimin e produkteve plehëruese

1. Të gjitha produktet plehëruese që prodhohen, importohen e tregtohen për t’u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.

2. Një produkt plehërues mund të regjistrohet, nëse përmbush kërkesat, si më poshtë:

- a) produkti plehërues të jetë i miratuar, sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji;
- b) lënda ushqyese garanton siguri, cilësi dhe efektshmëri;
- c) ekzistojnë metodat e analizave dhe të testimeve;
- ç) nuk ndikon negativisht në shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe në mjedis;
- d) përmbush të gjitha kërkesat për ambalazhimin, etiketimin dhe magazinimin, sipas dispozitave të këtij ligji;
- dh) përmbush kufijtë e tolerancës.

Neni 8

Aplikimi dhe procedura për regjistrimin e produkteve plehëruese

1. Aplikimi për regjistrimin e produktit plehërues përmban:

- a) kërkesën e aplikantit për regjistrimin e produktit plehërues në gjuhën shqipe;
- b) të dhënat teknike të produktit plehërues në gjuhën shqipe ose angleze;
- c) etiketën, të përkthyer dhe në gjuhën shqipe;
- ç) dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS). MSDS të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat specifike, përmbajtjen e formatin e përcaktuar nga legjislacioni përkatës në fuqi për kimikatet;
- d) mostrën e produktit plehërues që kërkon të regjistrojë.

2. Aplikimi për regjistrim, sipas shkronjave “a” dhe “ç”, të këtij neni, kryhet në sistemin *online*, ndërsa mostra, sipas shkronjës “d”, të këtij neni, depozitohet te laboratorit i referencës.

3. Pas pranimit, ky dokumentacion dërgohet nga SPPP-ja te laboratorit i referencës, për të kryer vlerësimin e të dhënave të produktit plehërues, të cilin e pasqyron në sistemin *online* brenda 5 ditëve.

4. Procedura e regjistrimit të produktit plehërues përfundon brenda 20 ditëve nga aplikimi.

5. Përmbajtja e të dhënave teknike të produkteve plehëruese miratohet me urdhër të ministrit.

6. Procedura e hollësishme e regjistrimit të produkteve plehëruese miratohet me rregullore të ministrit.

Neni 9

Komisioni i regjistrimit të produkteve plehëruese

1. Komisioni është organ kolegjal teknik i përhershëm dhe vendimmarrës.

2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

- a) zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;
- b) dy përfaqësues nga SPPP-ja në ministri;
- c) një përfaqësues nga laborator i referencës;
- ç) një përfaqësues nga Agjencitë Përgjegjëse për Këshillimin Bujqësor;
- d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;
- dh) një përfaqësues nga shoqatat e fermerëve.

Sekretar i komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese është specialisti që mbulon produktet plehëruese pranë SPPP-së në ministri, i caktuar me urdhër të ministrit.

3. Anëtarët e komisionit miratohen me urdhër të ministrit, pas propozimit të bërë nga institucionet përkatëse.

4. Komisioni është organ vendimmarrës dhe funksionon si më poshtë:

- a) komisioni mbledhet kur e kërkon kryetari ose 2/3 e anëtarëve të tij;
- b) radha e shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrimin e produkteve plehëruese bëhet sipas datës së pranimit të tyre;
- c) komisioni i zhvillon mbledhjet me pjesëmarrjen e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij dhe, pasi shqyrton mendimet e laboratorit të referencës, merr vendim me 2/3 e anëtarëve të pranishëm;
- ç) komisioni, në mbledhjet e tij, shqyrton:
 - i) etiketën përfundimtare të produktit plehërues, bazuar në etiketën e paraqitur nga aplikanti;
 - ii) regjistrimin e produkteve plehëruese në procedurë regjistrimi;
 - iii) reregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji;
 - iv) çregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji;
 - v) modifikimin e dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

d) në përfundim të mbledhjes hartohet procesverbali përmbledhës për vendimet e marra. Procesverbali mbahet në dy kopje, nga të cilat, njërin e mban SPPP-ja dhe tjetra depozitohet në arkivin e ministrisë bashkë me një kopje të dokumenteve të regjistrimit (certifikatë dhe etiketë). Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje;

dh) dokumentet e regjistrimit (certifikata dhe etiketa) të produkteve plehëruese të miratuara përgatiten nga sekretari dhe firmosen nga kryetari i komisionit.

5. Vendimi për refuzimin e regjistrimit mund të ankimohet pranë ministrit.

6. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 10

Lista e produkteve plehëruese dhe lista e prodhuesve të produkteve plehëruese

1. SPPP-ja përgatit listën e produkteve plehëruese të regjistruara dhe listën e prodhuesve të produkteve plehëruese në vend dhe i publikon në faqen zyrtare të ministrisë sa herë që pësojnë ndryshime.

2. Lista e produkteve plehëruese të regjistruara përmban këto të dhëna:

- a) emrin tregtar;
- b) përmbajtjen e çdo përbërësi të produktit plehërues;
- c) emrin e aplikantit;
- ç) prodhuesin (emri, adresa e fabrikimit);
- d) grupin;
- dh) numrin dhe datën e regjistrimit;

e) importuesin (emri dhe adresa).

3. Lista e prodhuesve të produkteve plehëruese në vend përmban këto të dhëna:

a) prodhuesin (emrin, adresën e selisë ose të fabrikimit të produkteve plehëruese);

b) emrin/emrat tregtar/ë të produkteve plehëruese, që prodhon/prodhojnë;

c) grupin;

ç) numrin dhe datën e regjistrimit;

d) emrin/emrat e lëndëve të para, që përdor për prodhimin e produkteve plehëruese.

Neni 11

Tarifat administrative për regjistrimin e produkteve plehëruese

1. Tarifat administrative për regjistrimin e produkteve plehëruese përballohen nga aplikantët dhe derdhen në buxhetin e shtetit.

2. Tarifat administrative përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 12

Dokumenti i regjistrimit të produktit plehërues

1. Dokumenti i regjistrimit të produktit plehërues përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën. Certifikata e regjistrimit lëshohet nga kryetari i komisionit, jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes së komisionit dhe shoqërohet me etiketë.

Dokumenti i regjistrimit mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat, njëra mbahet në arkivin e ministrisë, njëra në SPMP, ndërsa kopja tjetër i jepet aplikantit.

2. Në certifikatën e regjistrimit, e cila plotësohet në gjuhën shqipe, jepen të dhënat si më poshtë:

a) emri tregtar;

b) numri dhe data e regjistrimit;

c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;

ç) emri i prodhuesit dhe adresa e tij;

d) emri i importuesit në Shqipëri dhe adresa e tij;

dh) grupi;

e) pamja e jashtme e tij;

ë) përmbajtja;

f) afati i vlefshmërisë;

g) mënyra e përdorimit (me shënimin: Shih etiketën bashkëlidhur!).

3. Në etiketën e produktit plehërues jepen të dhënat si më poshtë:

a) emri tregtar;

b) numri dhe data e regjistrimit;

c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;

ç) emri i prodhuesit dhe adresa e tij;

d) emri i importuesit në Shqipëri dhe adresa e tij;

dh) emri i pakuesit, nëse kryhet paketimi në Shqipëri dhe adresa e tij;

e) emri i grupit, i cili shkruhet me shkronja të mëdha;

ë) pamja e jashtme e tij;

f) përmbajtja e përbërësve të produktit plehërues, përfshirë edhe përmbajtjen e elementeve të përshkruara me fjalë e simbole kimike dhe në lidhje me ushqyesit e format e tretshme;

g) numri i serisë;

gj) mënyra e përdorimit;

h) sasia neto e produktit plehërues, që ndodhet në ambalazhin parësor;

i) afati i ruajtjes;

j) kushtet e ruajtjes;

k) udhëzimet për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, sigurinë e mbrojtjen e mjedisit.
Përmbajtja e etiketës duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 4, të nenit 17, të këtij ligji.

Neni 13

Riregjistrimi, çregjistrimi dhe modifikimi i dokumenteve të regjistrimit të produkteve plehëruese të regjistruara

1. Riregjistrimi i produktit plehërues bëhet direkt nga komisioni, kur ky kërkohet nga aplikanti, 30 ditë para përfundimit të afatit të regjistrimit.

2. Çregjistrimi i produktit plehërues kryhet nga komisioni në rastet kur:

- a) produkti plehërues përmban lëndë ushqyese, të cilat janë të hequra me urdhër të ministrit;
- b) aplikanti e kërkon me shkrim një gjë të tillë;
- c) nuk vazhdon të plotësojë kërkesat, sipas nenit 7 të këtij ligji.

Në rastet e çregjistrimit njoftohet aplikanti.

Pas çregjistrimit, nëse produkti plehërues është ende në treg, duhet të përdoret brenda afateve të skadencës së tij, për rastet e cituara në shkronjën “b”, të kësaj pike, dhe të tërhiqet nga tregu, nga importuesi ose nga prodhuesi për rastet e cituara në shkronjat “a” dhe “c” të kësaj pike. Monitorimi i tërheqjes nga tregu kryhet nga institucioni përgjegjës.

3. Modifikimi i dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues kryhet nga komisioni kur ka ndryshim të:

- a) emrit tregtar;
- b) mbajtësit të dokumentit të regjistrimit (aplikanti);
- c) prodhuesit;
- ç) prodhimit (shtim, transferim në një stabiliment tjetër prodhues);
- d) mënyrave të përdorimit dhe të sasive të përdorura;
- dh) periudhës dhe të kushteve të ruajtjes;
- e) zgjerimit të fushës së përdorimit.

Në të gjitha rastet e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, aplikanti duhet të paraqesë kërkesë në gjuhën shqipe, shoqëruar me dokumentacionin provues.

KREU III

TREGTIMI, TRANSPORTI, RUAJTJA, ETIKETIMI DHE PËRDORIMI I PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Neni 14

Tregtimi i produkteve plehëruese

1. Lejohet vetëm importimi dhe tregtimi i produkteve plehëruese të regjistruara.

2. Tregtimi me shumicë dhe me pakicë i produkteve plehëruese me rrezikshmëri përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Në njësitë e tregtimit me pakicë të produkteve plehëruese ndalohet:

- a) mbajtja dhe tregtimi i produkteve plehëruese, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
- b) asgjësimi i ambalazheve dhe i produkteve plehëruese të skaduara apo të dëmtuara;
- c) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz e kafshë;
- ç) riambalazhimi i produkteve plehëruese, pasi janë vendosur në treg.

3. Institucioni përgjegjës në pikat e kalimit kufitar (PIK) ka për detyrë:

- a) të kontrollojë e të verifikojë produktet plehëruese që hyjnë për t’u tregtuar dhe përdorur në Republikën e Shqipërisë e t’i evidentojë ato në një regjistër të veçantë;
- b) të ndalojë hyrjen në Republikën e Shqipërisë të produkteve plehëruese të paregjistruara.

4. Produktet plehëruese, të cilave u skadon afati i përdorimit, të klasifikohen si mbetje dhe të etiketohen sipas kodeve të përcaktuara në vendimin nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar.

5. Grumbullimi, transportimi, trajtimi dhe asgjësimi i produkteve plehëruese të klasifikuara mbetje të trajtohen sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 15

Transporti, ruajtja dhe magazinimi i produkteve plehëruese

1. Transporti i produkteve plehëruese bëhet me mjete të sigurt e të përshtatshme, të mbuluara tërësisht, si masë mbrojtjeje, në çdo rast, nga kontakti me lagështirën, si dhe mënjanon rrjedhjet gjatë udhëtimit.

2. Të gjitha produktet plehëruese, pas prodhimit apo sjelljes nga importi, ruhen në magazinat e tregtimit me shumicë, si dhe në mjediset e tregtimit me pakicë.

3. Kushtet në magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë duhet të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të produkteve plehëruese, sipas kërkesave të përcaktuara në etiketë, si dhe përmbushjen e kërkesave në fuqi për mbrojtjen e mjedisit e kimikatet.

4. Magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë të produkteve plehëruese duhet të jenë të pajisura me:

a) mjetet e nevojshme për thithjen e dezaktivizimin e rrjedhjeve të produkteve plehëruese të rrjedhura;

b) këndin e ndihmës së shpejtë dhe mjetet mbrojtëse individuale;

c) pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;

ç) mjediset higjieno-sanitare me ujë të rrjedhshëm;

d) sistemet e duhura të ajrimit.

5. Produktet plehëruese, gjatë magazinimit, duhet:

a) të jenë të ndarë nga njëri-tjetri;

b) të jenë të etiketuara në mënyrë të qartë;

c) të mos jenë të përziera me substanca të tjera;

ç) të jenë në ambalazhe parësore të padëmtuara.

Neni 16

Ambalazhimi dhe etiketimi i produkteve plehëruese

1. Produktet plehëruese mund të vendosen në treg vetëm të ambalazuara.

2. Ambalazhi duhet të ruajë karakteristikat fizike dhe kimike të produkteve plehëruese.

3. Ambalazhi parësor, që është në kontakt direkt me produktin plehërues, duhet të jetë i mbyllur në mënyrë të tillë që, në rast se hapet, të jetë e pamundur të rimbyllet.

4. Etiketa të jetë e ngjitur në mënyrë të pashqitshme në ambalazhin parësor të produktit plehërues, si dhe përmbajtja e saj të jetë qartësisht e lexueshme dhe jo e shuajtshme.

5. Ambalazhimi dhe etiketimi i produkteve plehëruese me rrezikshmëri përfshihet në licencën “Prodhimi”, me kodin II.5.B.1.

Neni 17

Përdorimi i produkteve plehëruese

1. Lejohet vetëm përdorimi i produkteve plehëruese të regjistruara.

2. Produktet plehëruese duhet të përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet që jepen në etiketë.

3. Përdorimi i produkteve plehëruese duhet të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve, të konsumatorëve, të kafshëve dhe të mjedisit.

4. Rregullat e hollësishme për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe aktet nënligjore për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve.

KREU IV

KUFIJTË E TOLERANCËS. PRODUKTET PLEHËRUESE TË THJESHTA ME BAZË NITRAT AMONI, ME PËRMBAJTJE TË LARTË AZOTI

Neni 18

Kufijtë e tolerancës

1. Përmbajtja e deklaruar në produktet plehëruese duhet të jetë në përputhje me kufijtë e tolerancës.

2. Në përcaktimin e kufijve të tolerancës merren parasysh variacionet në aspektin e prodhimit, marrjes së mostrave për analizë, pasiguritë e matjeve, si dhe metodat analitike të përdorura.

3. Prodhuesi nuk mund të përfitojë sistematikisht nga kufijtë e tolerancës.

4. Kufijtë e tolerancës miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 19

Produktet plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti

1. Produktet plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, mund të përmbajnë substanca inorganike ose inerte. Substancat që janë përdorur në prodhimin e këtij produkti plehërues nuk duhet të rrisin ndjeshmërinë e tij ndaj nxehtësisë e ndaj shpërthimit.

2. Prodhuesi duhet të sigurojë që produktet plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, duhet të plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

3. Kontrolli, analizat dhe testimet zyrtare të produkteve plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, të referuara në këtë nen, duhet të jenë në përputhje të plotë me standardet e harmonizuara apo të miratuara nga institucioni përgjegjës për standardizimin.

4. Për të siguruar gjurmueshmërinë e produkteve plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, të vendosura në treg, prodhuesi mban një regjistër të veçantë vetëm për këtë lloj produkti plehërues, ku përcaktohen emri, adresa dhe vendndodhja e prodhuesit, si dhe e përdoruesve të tij. Ky regjistër duhet të jetë i disponueshëm për kontrollet që kryhen për të gjithë periudhën e vendosjes në treg të këtij produkti plehërues.

5. Prodhuesi duhet të sigurojë që produkti plehërues me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, që vendoset në treg, të ketë kaluar testin e rezistencës ndaj shpërthimit. Ky test duhet të jetë bërë në një laborator testues të akredituar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kalimi i testit të shpërthyeshmërisë është kusht i domosdoshëm për të gjitha produktet plehëruese që vendosen në treg.

KREU V

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE

Neni 20

Organizimi

(Ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij janë si më poshtë:

- a) struktura përgjegjëse për produktet plehëruese (SPPP) në ministri;
- b) struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen, inspektimin dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese;
- c) komisioni i regjistrimit të produkteve plehëruese (KRPP) në ministri;
- ç) laborator i referencës dhe laboratorët e miratuar.

Neni 21

Struktura përgjegjëse për produktet plehëruese

SPPP-ja ka këto detyra:

- a) zhvillon procedurat që lidhen me regjistrimin e produkteve plehëruese, në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
- b) ndjek e monitoron aktivitetin e produkteve plehëruese në nivel qendror dhe rajonal, në zbatim të këtij ligji.

Neni 22

Institucionet përgjegjëse

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Institucioni përgjegjës për inspektimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar

1. Laboratori i referencës miratohet me urdhër të ministrit dhe ka për detyrë:
 - a) vlerësimin e të dhënave teknike të produkteve plehëruese gjatë procedurës së regjistrimit të tyre;
 - b) kryerjen e analizave laboratorike zyrtare të produkteve plehëruese;
 - c) testimin e produktit plehërues, sipas standardeve përkatëse dhe vlerësimin, nëse është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;
 - ç) kryerjen e analizave të mostrave të produkteve plehëruese, që merren për efekt verifikimi dhe vlerësimin e treguesve cilësorë të tyre;
 - d) hartimin e raportit teknik, sipas pikës 3, të nenit 8, të këtij ligji;
 - dh) vlerësimin e laboratorëve të miratuar për:
 - i) rezultatet e analizave të kryera;
 - ii) bashkërendimin e punës dhe dhënien e mbështetjes, përfshirë trajnimet e shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që ato kryejnë;
 - iii) organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara.
2. Laboratorët miratohen me urdhër të ministrit dhe kanë për detyrë kryerjen e analizave laboratorike të produkteve plehëruese të hedhura në treg.
3. Laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar miratohen vetëm pasi të jenë akredituar. Lista e analizave të miratuara duhet të jetë e përfshirë në listën e analizave për të cilat ato janë akredituar dhe miratohet me urdhër të ministrit.
4. Kriteret që duhet të plotësojë laborator i referencës dhe laboratorët e miratuar, si dhe procedura për miratimin e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Metodat e analizave të produkteve plehëruese të jenë në përputhje me standardet e harmonizuara apo të miratuara nga institucioni përgjegjës për standardizimin.

6. Tarifat e shërbimeve të analizave, që kryhen nga laboratorit i referencës dhe laboratorët e miratuar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit.

KREU VI ANALIZIMI, GJURMUESHMËRIA DHE REKLAMIMI I PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Neni 24 **Analizimi**

1. Analizat laboratorike të mostrave të produkteve plehëruese bëhen në laboratorin e referencës dhe në laboratorët e miratuar, sipas metodave të përcaktuara në pikën 5, të nenit 23, të këtij ligji.

2. Kontrolli për cilësinë e produkteve plehëruese të vendosura në treg kryhet në bazë të planit vjetor të marrjes dhe të analizimit të mostrave, miratuar me urdhër të ministrit.

3. Rregullat për marrjen e mostrave, analizat e procedurat, dhënia e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimi i analizave të produkteve plehëruese janë në varësi të metodave apo të standardeve me të cilat kryhet testimi.

Neni 25 **Gjurmueshmëria**

1. Gjurmueshmëria përcaktohet në të gjitha nivelet e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese.

2. Prodhuesit dhe tregtuesit e produkteve plehëruese krijojnë sisteme për mbajtjen e të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin në çdo çast të produktit plehërues, si dhe të çdo personi fizik apo juridik që i ka furnizuar apo është furnizuar me produkte plehëruese. Këto të dhëna ruhen për tre vjet dhe vihen në dispozicion të institucionit përgjegjës.

3. Për qëllimet e gjurmueshmërisë së produkteve plehëruese nga SPPP-ja në ministri mbahet “Regjistri i produkteve plehëruese”, i cili përmban një seksion të veçantë për ata që lejohen në bujqësinë organike, si dhe “Regjistri i prodhuesve të produkteve plehëruese”.

Neni 26 **Informimi dhe reklamimi i produkteve plehëruese**

1. Ministria publikon në faqen e saj zyrtare listën e produkteve plehëruese që lejohet të qarkullojnë në vendin tonë, si dhe median e shkruar ose elektronike, prodhuesit, importuesit, tregtuesit për veprimtaritë e organizuara lidhur me sigurinë, cilësinë, efektshmërinë, përdorimin dhe parandalimin e rreziqeve nga tregtimi dhe përdorimi i produkteve plehëruese.

2. Reklamimi në median e shkruar ose elektronike bëhet nga aplikanti dhe lejohet vetëm për produktet plehëruese të regjistruara dhe në përputhje me dokumentin e regjistrimit.

3. Ndalohet reklamimi në median e shkruar ose elektronike i produkteve plehëruese me rrezikshmëri.

KREU VII VEPRIMTARI TË NDALUARA DHE MUNGESA NË PESHË. ASGJËSIMI I PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Neni 27 **Veprimtari të ndaluara**

Ndalohet prodhimi, importi, vendosja në treg dhe përdorimi:

- a) i produkteve plehëruese të paregjistruara;
- b) i produkteve plehëruese me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose një rrezik për mjedisin;
- c) i produkteve plehëruese të falsifikuara;
- ç) i produkteve plehëruese të tjetërsuara;
- d) i produkteve plehëruese me përmbajtje të padeklaruara;
- dh) i produkteve plehëruese të skaduara.

Neni 28

Pesha neto e produkteve plehëruese

1. Pesha neto e produkteve plehëruese të ambalazhuara për tregtim duhet të jetë e njëjtë me atë të shkruar në etiketë. Kufijtë e tolerancës miratohen me urdhër të ministrit.
2. Prodhuesi nuk mund të përfitojë sistematikisht nga kufijtë e tolerancës.

Neni 29

Asgjësimi i produkteve plehëruese dhe i ambalazheve të tyre

1. Produktet plehëruese, ambalazhet dhe materialet e tjera, që duhet të asgjësohen ose të trajtohen, janë:
 - a) produktet plehëruese, të cituara në shkronjat “b”, “c”, “ç” e “d”, të nenit 27, të këtij ligji;
 - b) produktet plehëruese që kanë rrjedhur gjatë ruajtjes e transportit dhe materialet e përdorura për thithjen e dezaktivizimin e tyre;
 - c) ambalazhet, si: fuçi, bidonë, shishe, kuti, qese dhe objekte të tjera të ngjashme, të boshatisura;
 - ç) sendet e ndotura gjatë punës, si: pajisje mbrojtëse, enë të ndryshme, mjete pastrimi, objekte të tjera të ngjashme, të cilat nuk mund të përdoren më.
2. Importuesit dhe prodhuesit e produkteve plehëruese, për produktet plehëruese të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, janë të detyruar t’i largojnë ato nga territori i Republikës së Shqipërisë ose të bëjnë djegien (incinerimin) e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndotjen e mjedisit.
3. Asgjësimi i produkteve plehëruese me djegie brenda territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet nga subjekte të specializuara për këtë qëllim, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për lejet e licencat.
4. Rastet e përmendura në shkronjat “b”, “c” e “ç”, të pikës 1, të këtij neni, trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

KREU VIII

KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 30

Kundërvajtje administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me:

a) gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25, dhe të nenit 28, të këtij ligji;

b) gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 3, të nenit 14, pikat 1, 4 e 5, të nenit 15, nenin 16, si dhe pikat 4 e 5, të nenit 19, të këtij ligji;

c) gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me nenin 6, pikat 1 e 2, të nenit 14, pikën 1, të nenit 18, si dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji;

ç) gjobë 500 000 (pesëqind mijë) lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me nenin 27, si dhe në rast përsëritjeje të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në pikat 1 e 2, të nenit 14, pikën 1, të nenit 6, si dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji.

2. Për shkeljet e dispozitave të këtij ligji, të cilat, sipas pikës 1, të këtij neni, përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç masës së vënies së gjobës, e cila është dënim kryesor, vendosen edhe dënime plotësuese, si: masa e kthimit të ngarkesave, në rastin e shkeljeve të dispozitave të nenit 27, të këtij ligji; heqja e së drejtës së tregtimit me shumicë ose pakicë dhe heqja e licencës aty ku parashikohet licencimi, në rastin e shkeljeve të dispozitave të shkronjave “b”, “c” dhe “d”, të nenit 27, të këtij ligji; asgjësimi, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 29, të këtij ligji, si dhe masa urgjente, si: masa e bllokimit, në rastin e shkeljeve të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “e”, të nenit 27, të këtij ligji, dhe masa e bllokimit, në rast përsëritjeje të shkeljeve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.

3. Të gjitha të ardhurat nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 31

Procedurat e kundërvajtjes administrative

(Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Marrja e masave administrative nga struktura përgjegjëse për inspektimin bëhet sipas legjislacionit për inspektimin. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në përputhje me përcaktimet në ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 32

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë, brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore, në zbatim të pikës 4, të nenit 17; të nenit 22; dhe të pikës 6, të nenit 23, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë, brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore, në zbatim të pikës 2, të nenit 5; të pikave 5 e 6, të nenit 8; të pikave 2, 3 e 6, të nenit 9; të pikës 3, të nenit 18; të pikave 1, 2, 3 e 4, të nenit 23; dhe të nenit 28, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për financat të nxjerrin, brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore, në zbatim të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji.

Neni 33

Shfuqizimet

1. Ligji nr. 10 390, datë 3.3.2011, “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, shfuqizohet.

2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktuara në nenin 32, të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 10 390, datë 3.3.2011, “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”, për aq sa përputhen me ligjin në fuqi.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.2.2020

**Shpallur me dekretin nr. 11447, datë 6.3.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**